

Fatkeqësitë Natyrore

- **Parashikimi**
- **Monitorimi**
- **Menaxhimi**

Dr. Tanja Porja

UT, FSHN (Fizika e Mjedisit)


A2 - CNN Exclusive News Channel Affiliate

Tiranë, 28 prill 2022

Cfarë nënkuptojmë me fatkeqësi natyrore?

- ▶ Fatkeqësitë natyrore janë dukuri të natyrës me pasoja të rënda në jetën dhe aktivitetin njerëzor. Teknikisht, një fenomen natyror, ka dy mënyra të përcaktimit të tij si ekstrem:
 - ▶ 1 - shqyrtohet probabiliteti që një ngjarje e një ashpërsie të caktuar të ndodhë brenda një periudhe të caktuar në një zonë të caktuar KU sa më e ulët probabiliteti i ndodhjes aq më ekstreme konsiderohet ngjarja ($P < 10\%$).
 - ▶ 2 - shqyrtohen pragjet e paracaktuara të një ngjarje ekstreme/normale (nr. i ditëve të njëpasnjëshme mbi 37°C , që përcakton valët ekstreme të nxehtësisë) të cilat VAREN NGUSHTË nga zona ku këto ngjarje pritet të ndodhin.

- ▶ Fatkeqësitë natyrore më të shumta me të cilat përballet Shqipëria, janë përmbytjet me 32% dhe tërmetet me 18% të numrit total të fatkeqësive natyrore por ka edhe fatkeqësi të natyrave të tjera dhe që kryesisht derivojnë nga origjina hidrometeorologjike.



- ▶ Vlen të theksohet se fatkeqësitë natyrore me origjinë hidrometeorologjike, përbëjnë 67% ku pjesa më e madhe i takon përmbytjeve dhe temperaturave ekstreme prej të cilave derivojnë dhe fatkeqësitë e thatësirave dhe epidemive.

- ▶ Shqipëria, në të shkuarën, të tashmen por akoma më tepër në të ardhmen do të përballlet me fatkeqësi natyrore si stuhi, përmbytje, valë nxehtësie, thatësira dhe zjarre.
- ▶ Është vrojtuar më parë, por më e theksuar në 2 dekadat e këtij shekulli, ka shpeshtim të ngjarjeve të motit ekstrem të cilat fitojnë statusin e fatkeqësisë natyrore (më të freskëtat përmbytjet 2010, 2015, 2019, 2021 dhe valët e nxehtësisë 2015 - 2021).
- ▶ Skenarët klimatikë parashikojnë SHPESHTIM & ASHPËRSIM të ngjarjeve të motit ekstrem që prodhojnë fatkeqësi natyrore.

ÇFARË PARASHIKOHET NË KËTË DREJTIM ?

Climate change is one of the biggest challenges facing our world, responsible for an increase in extreme weather events such as heatwaves, hurricanes and drought.



- ▶ Në shkallë globale për vitin 2015, janë regjistruar 126 fatkeqësi natyrore (viti më i keq)

Po në Shqipëri cfarë do të ndodhë?

- ▶ Janë 2-3 fishuar valët e të nxehtit (nga 2/5 vite në 1 ngjarje/vit)
- ▶ Janë zgjatur valet e të nxehtit me të paktën 2 ditë
- ▶ Është 2-fishuar nr. i ditëve shumë të nxehta ($T_{max} > 40^{\circ}\text{C}$) dhe nr. i netëve tropikale gjatë vitit ($T_{min} \leq 20^{\circ}\text{C}$)
- ▶ Janë 2-fishuar stuhitë e erës/stuhitë detare dhe janë thyer rekorde historike të (TXx) për disa qytete
- ▶ Janë shpeshtuar ngjarjet me reshje ekstreme/përmbytje urbane
- ▶ Është rritur sasia e reshjeve 24h

Si mund të zvogëlohet impakti i fatkeqësive natyrore ?

- ▶ Parashikueshmëria - për të parandaluar që VARET nga aftësia dhe mundësia për t'i paraprirë një ngjarje (në Shqipëri të dy këto hapa janë në nivele deri të kënaqshme)
- ▶ Menaxhimi - për të minimizuar/rehabilituar që VARET nga legjislacioni, strukturat, organizimi dhe buxheti (në Shqipëri Ligji për Mbrojtjen Civile që nga 2004 u rinovua në 2019; struktura deri në 2019 ishte në kuadër të një Drejtorie Emergjencash POR sot ka një AKMC; organizimi edhe sot ka mjaft të meta, buxheti është I ULËT nëse i referohemi RISKUT të lartë që Shqipëria ka ndaj fatkeqësive natyrore).

► Pyetja është:

- Pas shumë fatkeqësive të përballuara, a kemi mësuar të menaxhojmë më mirë?

► Përgjigjia është PO !

- Cdo fatkeqësi me të cilën përballemi ka shërbyer për të menaxhuar më mirë, fatkeqësinë pas-ardhëse!

► Aktualisht në Shqipëri janë realizuar:

- Krijimi i Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, 2019
- U rishkrua Ligji për “*Mbrojtjen Civile*”, 2019
- AKMC - me zyrë qendrore dhe zyra rajonale në Shkodër, Durrës, Fier dhe Korçë DUKE shtuar edhe zyrat e Emergjencave Civile në cdo bashki (në rastin e Tiranës edhe njësitë bashkiake)
- Buxhet i ulët (vetëm 4% të buxhetit vjetor të bashkive, që vjen buxheti i shtetit.)

SI FUNKSIONON MENAXHIMI I NJË FATKEQËSIE NATYRORE?

- Monitorim dhe zbatim i politikave të Mbrojtjes Civile deri në nivel local
- Kryhen operacione të emergjencës civile

Për të arritur këto qëllime:

- ▶ HARTOHEN PLANET e emegjencave me masat parandaluese dhe përballuese të fatkeqësive
- ▶ KA një Sistem që siguron Mbrojtjen Civile (mbrojtja e jetës, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore nga e mjedisit)
- ▶ Ekziston një zinxhir institucionesh që punojnë për Mbrojtjen Civile që nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave te Komisioni Teknik Këshillimor i AKMC dhe deri në qendrat e mbrojtjes civile në rang qarku, bashkie duke shtuar edhe Korpuset e Vullnetarëve.

Gjermania, SUPER stuhitë që e kanë goditur

- ▶ **2002:** përmbytjet në lumin Elba detyruan evakuimin e 250 mijë banorëve në Gjermani me një kosto financiare €12 mln dhe 55 humbje jete
- ▶ **2007:** stuhia Kiril - uragani më e fortë i vrojtuar në Gjermani shkuli 62 mln pemë në Gjermani dhe humbën jetën 47 persona me një kosto €10 mln
- ▶ **2008:** stuhia Emma (180 km/h) shkuli pemë dhe cati, u rrezikua avioni i Lufthansës me 137 pasagjerë, 12 humbje jete dhe kosto 1.4mln USD
- ▶ **2010:** stuhia Xynthia e shkallës së uraganit - 64 humbje jete, kosto 3mln USD për Gjermani dhe shumë shtete të EU (Francë, Belgjikë, Hollandë). Kosto totale për vendet EU REZULTOI në 200 humbje jete dhe 25 mln USD

LIGJI GJERMAN & ORGANIZIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE

- ▶ Gjermania ka Plan Kombëtar për Mbrojtjen e Infrastrukturës (update 2009)
- ▶ Fatkeqësitë më të shpeshta natyrore janë STUHITË erës
- ▶ Dëme miliona dollarë dhe dhjetëra humbje jetësh për cdo fatkeqësi
- ▶ Pas përmbytjeve të Europës Qendrore në vitin 2002, 16 vende të EU Qendrore përfshirë Gjermaninë krijuan "New Strategy for Protecting the Population" e cila operon gjatë emergjencave civile.
- ▶ Kjo strategji bazohet **Emergency Planning Information System** ku përfshihen institucione si Agjensia e Mjedisit, Agjensia e Ndhmës Teknike, Shërbimi Meteorologjik Gjerman, Zyra Federale e Mbrojtjes Civile, etj.

SI FUNKSIONON ZINXHIRI?

- ▶ *Shërbimi Meteorologjik OFRON* “Early Warning - Forecast - County Warnings”
- ▶ Informacioni dërgohet për vendimarrje autoriteteve qendrore, lokale dhe institucioneve të linjës dhe si zjarfikëse, polici, shkolla, spitale, etj....
- ▶ Zyra Federale e Mbrojtjes Civile është pjesë e “Global Monitoring for Environment and Security - Emergency Response Service (GMES ERS)”.
- ▶ Agjensia e Ndhmës Teknike KRYEN funksionin e Min. së Brendshme duke ORGANIZUAR gjithë operacionet dhe ka një korpus me 76 mijë vullnetarë dhe 6.500 automjete

SI VIJON ZINXHIRI?

- ▶ *Gjermania ka Akademinë e Menaxhimit të Krizave dhe Hartimit të Planeve të Mbrojtjes*
- ▶ *Civile ku bëjnë pjesë ekspertë kombëtarë/ të huaj*
- ▶ *Gjermania është pjesë e iniciativave EU, të Menaxhimit të Krizave dhe mekanizmit të Mbrojtjes Civile*
- ▶ *Skuadrat e vullnetarëve (1.2 mln zjarrfikës, 5 organizata OJF dhe 500 mijë vullnetarë pranë Zyrës Federale e Mbrojtjes Civile).*
- ▶ *Gjermania aplikon vitin e vullnetarizmit SI NJË mundësi zëvendësimi e Shërb. Ushtarak të të rinjve (krijon gati 100 mijë vullnetarë cdo vit)*

PROBLEMATIKAT në Gjermani...?!

- ▶ Nr. i lartë agjensish me kordinim të varfër mes tyre
- ▶ Shpesh duplikohet puna dhe operacionet
- ▶ Fatkeqësitë lokale menaxhohen nga Landet
- ▶ Qeveria Gjermane ka vëmendje të vecante në “Disaster Risk Reduction”
- ▶ Gjermania ka ndërgjegjësim të lartë individual, komunal dhe kombëtar ndaj Fatkeqësive Natyrore.

FALEMINDERIT